

EVALDA PACI***STUDIME FILOLOGJIKE PËR LETËRSINË ROMANTIKE ARBËRESHE:
NJË ARRITJE E RE NË STUDIMET ALBANOLOGJIKE***

Vepra e botuar së fundmi, me autor studiuesin e mirënjohur Matteo Mandalà, ka në qendër të vëmendjes një problematikë që lidhet kryesisht me një disiplinë studimore mjaft të rëndësishme në lëmë të albanologjisë, me filologjinë e tekstit dhe me traditën e studimeve që lidhen me të. Bëhet fjalë për një *opus* që përmbledh një numër të konsiderueshëm kapitujsh e sythesh në të cilat trajtohen çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë jo vetëm me traditën shkrimore të veprave të letërsisë arbëreshe, por dhe me vetë historinë e letërsisë së shkruar shqiptare, rimarrja e së cilës nga studiuesit e sotëm do të kërkojë pa dyshim dhe një reimpostim të mjaft autorëve kryesorë përfaqësues të traditës së arealit arbëresh.

Duke qenë marrë prej vitesh me tekstet e vjetra shqipe por dhe me historinë e letërsisë së shkruar të viseve arbëreshe, duke qenë autor dhe përpilues i botimeve kritike të rëndësishme që radhiten krahas realizimeve më të rëndësishme të kësaj tradite, autori paraqitet me një vepër përmbledhëse në të cilët ka ritrajtuar inkuadrimin e veprave të disa autorëve arbëreshë në një kuadër filologjik bashkëkohor; historikun e kërkimeve të dorëshkrimeve dhe botimeve kritike që lidhen me to¹; historinë e leksikografisë shqiptare e arbëreshe si një pjesë e rëndësishme e traditës së studimeve filologjike²; jetëshkrimin e figurave kryesore të historisë së letërsisë arbëreshe, të cilave autori u ka kushtuar dhe më parë vëmendje dhe kohë reale studimi me realizimin e botimeve kritike që u bëjnë nder studimeve në fushë të filologjisë së tekstit dhe historisë së letërsisë së shkruar shqiptare. Përvoja e gjatë në këtë fushë shumëdimensionale kërkimesh dhe informacioni i vazhdueshëm mbi çdo

¹ Kontributi i autorit pikërisht në lidhje me këtë domenë pasqyrohet dhe në një botim të mëparshëm të realizuar në gjuhën shqipe. Shih dhe Mandalà M., *Gjurmime filologjike për letërsinë e vjetër arbëreshe*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.

² Shih në veçanti kreun *Gjurmimet leksikografike në mjedisin arbëresh të Sicilisë*, po aty, f. 257-280, në të cilin promovohet kontributi i arbëreshëve të Sicilisë në fushë të leksikografisë shqipe. Ky kapitull mbetet ndër më të rëndësishmit e veprës në fjalë, meqë në të paraqitet dhe një sprovë në drejtim të periodizimit të kontributeve dhe zhvillimit të kësaj discipline në arealin arbëresh, duke mos lënë mënjanë dhe përfshirjen dhe në këtë kontekst të teksteve të vjetra arbëreshe, ribotimi i të cilave riufron mundësinë për një shfrytëzim eficient të arsenalit leksikor të përmbajtur në to.

zhvillim të rëndësishëm në lidhje me argumentet e sipërpërmendura e bëjnë punimin një udhërrëfyes me vlerë për studiuesit por dhe për çdo të interesuar ndaj historikut të zhvillimit të një tradite shkrimore që, e lëvruar këtej Adriatikut, mbetet gjithsesi një faktor i rëndësishëm për një kontekst më të gjerë e më përfshirës që ka të bëjë me historinë e letërsisë shqipe dhe të shkrimit shqip, në veçanti në periudha që kërkojnë përherë vëmendje e ritrajtim pikërisht në lidhje me këndvështrimin që propozohet dhe nga autori i kësaj vepre.

Një pjesë e mirë e gjurmimeve këmbëngulëse të vetë autorit në këtë lëmë studimesh evidentohen përmes trajtesave të tilla. Interesin i tij për të njohur me hollësi përmbajtjen e arkivave të mjaft personaliteteve të kulturës e gjuhës sonë e ka pasuruar çdo kapitull përbërës të veprës me vërejtje e përfundime që janë fryt i një pune hulumtuese shumëvjeçare. Duke lexuar interpretimet e përmbajtura në vepër kuptohet se filologut i duhet të mbajë parasysh se puna e tij nuk mjaftohet asnjëherë me një botim të vetëm të një vepre. Gjithmonë në varësi të rrethanave që mundësojnë zbulime të reja e pasurime në drejtim të burimeve primare qofshin dhe në trajtë dorëshkrimi dhe ekzistuese në disa variante, puna e tij kërkon shtysë e arritje të mëtejshme, pse jo dhe në përputhje me zhvillimet e fundme të teknologjisë që vihet në përdorim të studiuesve dhe në rastin e realizimit të botimeve kritike.³ Dhe në këtë vepër të studiuesit Mandalà vihet re një prirje metodologjike që dallon dhe punimet e mëparshme të tij: shkrirja dhe gërshetimi i disiplinave studimore të afërta që, sidomos në rastin e filologjisë së tekstit, janë të domosdoshme të shihen pranë njëra-tjetrës dhe në shërbim të njëra-tjetrës. Një gjë e tillë ndihet pothuaj në çdo kapitull e në veçanti në ato hyrës, që përbëjnë njëkohësisht dhe një lloj shtrirjeje tematike që do të shtjellohet hap pas hapi në vazhdim të veprës.

Lexuesi vëren se në vepër tradita e studimeve përkatëse është përfshirë në mënyrën më shteruese të mundshme. Çdo arritje në lidhje me argumentet që trajtohen, të dhëna mbi personalitetet që janë pjesë e traditës së gjatë të krijimtarisë, por dhe të botimeve të teksteve në arbërisht, është evidentuar në mënyrë skrupuloze nga autori i veprës. Libri përbën një *medium* dhe në drejtim të përvetësimit të koncepteve themelore të disiplinës së filologjisë së tekstit, të ofruara për përshtatje dhe në lidhje me tekstet tona e në veçanti me ato të përgatitura së fundi për botim nga ekipe pune të specializuara nga Universiteti i Kalabrisë dhe ai i Palermos. Këto arritje përfshihen në një mënyrë ose në një tjetër gjatë trajtesave të përmbajtura në vepër dhe ky fakt përbën një tjetër

³ Shih në përbërje të veprës në fjalë dhe kreun me titull *Çështje paraprake të botimit të veprave të Zef Skiroit*, po aty, f. 181-220. Ky i fundit mbetet ndër më të zgjeruarit në përbërje të punimit, duke qenë përfshirës i mjaft çështjeve dhe fakteve që lidhen me jetën, krijimtarinë por dhe me botimin e veprës së këtij personaliteti të botës arbëreshe.

element për t'u vënë në dukje gjatë shqyrtimit të përmbajtjes së veprës. Vepra ka paragrafë të tërë në të cilët ndiqet një platformë e shtruar nga studiuesi mbi gjurmimet filologjike, platformë e cila na është bërë e njohur dhe nga botimet paraardhëse që mbajnë emrin e tij, një pjesë e të cilave janë realizuar dhe në Shqipëri. Për më tepër vepra ofron mundësinë e ndjekjes me interes të përshkrimeve jo me më pak vlerë të sytheve në të cilat protagonistë janë personazhe të rëndësishme përfaqësuese të letërsive që qasen me njëra-tjetrën, si në rastin e Skiroit dhe Pirandellos, në të cilat dalin në pah fakte mjaft të imëta dhe domethënëse që shpjegojnë rrethanat e përvijimit të dy personaliteteve të rëndësishme për kulturat dhe periudhat përkatëse që ato përfaqësojnë.⁴

Përfshirja në një vepër të vetme e disa orientimeve, një pjesë e mirë e të cilave dhe të përmendura më sipër, ofron pa dyshim një prirje në vijim dhe një avantazh për autorin: çdonjëra prej tyre mund të marrë përmasa të tjera në përbërje të botimeve monografike më vete, duke u shërbyer më së miri studiuesve dhe specialistëve të disiplinave përkatëse.

Kjo paraqitje e thukët mbi veprën më të fundit të dalë nga duart e prof. Mandalasë nuk ka si të mos ketë parasysh dhe objektivat në perspektivë të autorit që fatmirësisht i ka ndarë me të gjithë ne. Një punë e madhe e pret atë dhe me punimin e vyer të lënë në dorëshkrim nga i ndjeri Imzot Pal Skirò mbi librin e Gjon Buzukut, punim për të cilin kemi dëgjuar të flitet kryesisht nga bashkëkohësit e tij teksa ceknin çështje të historikut të zbulimit dhe rizbulimit të kësaj vepre themelore për studimet mbi tekstet e vjetra shqipe. Me këtë rast, i urojmë autorit frytshmëri të mëtejme në këtë fushë studimesh dhe me objektivat e ardhme të tij.

⁴ Shih në përbërje të veprës kreun *Aspekte dhe momente të formimit rinor të L. Pirandellos dhe të Zef Skiroit*, po aty, f. 221-256.

